# AKT THEMELIMI

1 - Krijohet shoqeriq tregetare private me pergjegjesi te kufizu e quajtur **"IMI - Farma"**.Qendra e selise saj do jete ne Tirane dhe do zhvilloje veprimtarine e saj bresnda dhe jashte vendit.

2 - NE perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi SHPK -ja "IMI Farma" do te kerkoje njohjen dhe rregjistrimin e saj si person juridik privat nga Gjykata e rethit te Tiranes,ne regjistrin tregetar si dhe do rregjistrohet ne finance dhe ne zyrat tatimore.

3 - Veprimtari e SHPK-se do te rregullohet nga normat e parashikuara ne kete akt dhe do te mbeshtetet ne legjislacionin Shqipetar ne fuqi dhe ate te vendeve te tjera ku do veproje.

4 - SHPK "IMI - FARMA" seline saj do e kete ne Tirane perkohesisht ne adresen: - Rruga Muhamet Gjollesha Nr.43/2.

VULA e shoqerise eshte gjashte kendore me madhesi 20 mm çdo brinj

ku eshte brenda shkrojtur me germa kapitale:

**SHPK**
**IMI - FARMA**
**SHQIPERI**

5 - Presidenti i SHPK-se pergjigjet ligjerisht dhe me kapitalin themelor e aktivin pozitiv te saj per gjithe detyrimet qe lindin ndaj shoqerise ne periudhen e veprimtarise se saj.

6 - Objekti i punes se SHPK -se eshte:

Blerja dhe shitja me shumice dhe pakice,neprmjet import-eksporti ose brenda vendit te produkteve farmaceutike dhe veterinere,te aparateve dhe pajisjeve mjekesore dentare dhe optike dhe te produkteve ushqimore e te perdorimit te gjere si dhe transportimin e tyre.

Per arritjen e objektit te punes se vet SHPK-ja mund te angazhohet ne cdo operacion financiar dhe tregetarte neviojeshme,mund te mare pjese ne shoqeri te tjera brenda dhe jashte vendit qe kane objekte te ngjashme me te vetin ose qe lidhen direkt ose indirekt me te.

7 - Kapitali themelor i SHPK-se "IMI - Farma" eshte 100 000 LEK Ky kapital mund te rritet ne te ardhmen ne perpjesetim me ecurine e veprimtarise qe do realizoje shoqeria.

8 - SHPK "IMI - Farma" ka te drejte te çele filiale dhe perfaqes ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjisla cionin shqipetar dhe te vendeve ku mund te ngrihen.

9 - Shoqeria mund te perdore gjithe format e njohura me ligj per zgjerimin e saj duke krijuar edhe ortakeri.Maredhenjet e reja do te saktesohen me kontrata dhe sipas legjislacionit qe do jete ne fuqi.

10 - Per drejtimin e gjithe veprimtarise se SHPK-se caktohen administratore,ndersa per kryerjen e veprimtarise konkrete punesohet persone dhe punonjes me pergatitje profesionale sipas nevojes dhe rregullave te caktuara ne legjislacionin ne fuqi.Per kete do behen kontrato te neneshkruara nga te dy palet.

11 - Gjithe ortaket dhe personeli e konsiderojne detyre,rruajtjen e karakterit te fshehte te dokumentacionit,informatave,njohurive dhe pervojes se realizuar ne kuadrin e punes ne kete SHPK.

12 - Kohe zgjatja e veprimtarise se SHPK-se "IMI Farma" percaktoh per dhjete vjet,por ajo mund te zgjatet me tej ketij afati.Ne fund te çd viti behet bilanci i veprimtarise vjetore te SHPK-se dhe percaktohet programi per vitin e ardheshme.

13 - Ky akt mund te ndryshohet dhe plotesohet me pelqimin unanim te ortakeve dhe administratoreve te saj.

14 - Akt themelimi i mesiperm fiton vlefshmerine juridike me neneshkrimin e tij nga Presidenti i SHPK-se, vertetimit te tij noterial dhe miratimit te tij ligjor nga Gjykata e rethit te Tiranes duke e regjistruar edhe ne Regjistrin tregetar qe mbqhet pPej saj.

Presidenti i SHPK

"IMI - Farma"

Irakli Mio

# S T A T U T I

## i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

## " I M I - FARNA "

### Neni 1

**SHPK,Emertimi dhe forma shoqerore e saj**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar - SHPK " I M I - FARMA eshte person juridik privat,e krijuar nga shtetasi Shqiptar Irakli Jani Mio,qe ushtron veprimta ri tregetare blerje - shitje me shumice dhe pakice,import-eksport te produkteve farmaceutike dhe veterinare, aparateve dhe pajisjeve mjekesore dhe veterinare dhe te produkteve ushqimore dhe te perdorimit te gjere ne Republiken e Shqiperise.

### Neni 2

**Vend ndodhja dhe drejtimi i SHPK -se**

Vend ndodhja e SHPK-se "IMI - Farma" eshte ne Tirane dhe qendra e saj administrative ndodhet ne adresen:Rruga Muhamet Gjollesha Nr 43/2.

Ne te ardhmen qendra e saj administrative mund te ndryshoje vend qendrim dhe mund te krijoje perfaqesi dhe agjensi te tjera ne Republiken e Shqiperise dhe jashte saj.

### Neni 3

**Kohe zgjatja**

Veprimtari e SHPK "IMI - Farma" do te realizohet per nje kohe te pa percaktuar,por jo me pak se dhjete vjet.

Veprimi i pare ushtrimor fillon ne diten e regjistrimit te kesaj SHPK-je ne Gjykaten e rethit te Tiranes e ne organet e tjera kompetente dhe do te mbyllet ne daten 31 dhjetor te çdo viti.

### Neni 4

**Objekti**

SHPK " IMI - Farma" ushtron veprimtari tregetare private dhe objekt i punes se saj eshjte:Blerje dhe shitje me shumice dhe pakice, nepermjet importit dhe eksportit,ose brenda vendit te produkteve farmaceutike dhe veterinare,te aparateve dhe pajisjeve mjekesore,dentare dhe optike,dhe te produkteve ushqimore e te perdorimit te gjere,si dhe transportimin e tyre.

Veprimtari e kesaj SHPK-je mund te plotesohet ne vazhdimesi ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

Neni 5

**Kapitali themelor**

Kapitali themelor i SHPK-se "IMI - Farma" eshte 100 000 Lek. Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta me vlere 2000 lek sejcila. SHPK-ja mer persiper te perballoje humbjet me vêren e kapitalit themelor te saj dhe do shlyej detyrimet e saja me aktivin pozitiv qe do disponoje.

Neni 6

**Vula**

SHPK "IMI - Farma" ka vulen e saj me forme gjashte kendore me madhesi te brinjeve 20 mm,ku eshte brenda shkrojtur me germa kapitale

**SHPK**
**IMI - FARMA**
**SHQIPERI**

NENI 7

**Administrimi**

President i shoqerise esht Irakli Mio,ndersa administrator esht caktuar Jani Mio.Administratori do te kryeje te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise dhe e angazhon ate ne maredhenjet me te tretet nepermjet akteve qe jqne ne perputhje me objektin e saj.Per kryerjen e veprimtarise se saj SHPK-ja mund te angazhoje personel ne numur dhe me pregatitje profesionale sipas nevojave te veprimtarise se saj.Punonjesit caktohen nga presidenti i SHPK-se duke caktuar me dokument te vecante detyrat dhe te drejtat e sejcilit.

Neni 8

**Punesimi**

Marja dhe punesimi e trajtimi ne pune i personelit nga SHPK-ja behet mbi bazen e kondratove,te neneshkruara nga te dy palet dhe duke plotesuar gjithe kerkesat e caktuara per kete fushe nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 9

**Mosmareveshjet**

Ne se gjate veprimtarise se SHPK-se lindin mosmareveshje me te tretet,ose me personelin e angazhuar ne pune,do te behen te gjitha perpjekjet per ti zgjidhur ato me mirekuptim dhe ne se kjo nuk arrihet do te zgjidhen nepermjet rruges gjyqesore.

## Neni 10

### Dispozita te pergjitheshme

Ky statut depozitohet prane organeve kompetente dhe gjate ushtrimit tee veprimtarise mund te permiresohet ne perputhje me mundesitoqe krijohen edhe nga persosja e legjislacionit.

Presidenti i SHPK

" IMI - Farma"

Irakli Mio